



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/34
Datë: 01.09.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 shtator 2026, merr këtë:

V E N D I M


Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25 shkurt 2022, për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare "me qëllim të linjësimit të politikës së jashtme të Republikës së Kosovës me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (CFSP) të Bashkimit Evropian"

1. Pika 1. e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25 shkurt 2022, plotësohet si në vijim: Qeveria e Republikës së Kosovës zbaton sanksionet e vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes:
 - 1.1. Vendim i Këshillit (CFSP) 2026/1939, i datës 7 gusht 2026, që ndryshon Vendimin 2014/145/CFSP në lidhje me masat kufizuese ndaj veprimeve që minojnë ose kërcënojnë tërësinë territoriale, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës;
 - 1.2. Vendim i Këshillit (CFSP) 2026/1079, i datës 11 maj 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2019/797 në lidhje me masat kufizuese kundër sulmeve kibernetike që kërcënojnë Bashkimin Evropian ose shtetet e tij anëtare;
 - 1.3. Vendim i Këshillit (CFSP) 2026/1072, i datës 11 maj 2026, që ndryshon Vendimin 2014/145/CFSP në lidhje me masat kufizuese ndaj veprimeve që minojnë ose kërcënojnë tërësinë territoriale, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës;
 - 1.4. Vendim i Këshillit (CFSP) 2026/1105, i datës 18 maj 2026, që ndryshon Vendimin 2013/255/CFSP në lidhje me masat kufizuese, duke marrë parasysh situatën në Siri;
 - 1.5. Vendim Zbatues i Këshillit (CFSP) 2026/1106, i datës 18 maj 2026, për zbatimin e Vendimit 2013/255/CFSP në lidhje me masat kufizuese, duke marrë parasysh situatën në Siri;
 - 1.6. Vendim i Këshillit (CFSP) 2026/1173, i datës 28 maj 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2024/385 për vendosjen e masave kufizuese kundër atyre që mbështesin, lehtësojnë ose mundësojnë veprime të dhunshme nga Hamasi dhe Xhihadi Islamik Palestinez;
 - 1.7. Vendim i Këshillit (CFSP) 2026/1176, i datës 28 maj 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2020/1999 në lidhje me masat kufizuese kundër shkeljeve dhe abuzimeve të rënda të të drejtave të njeriut;
 - 1.8. Vendim i Këshillit (CFSP) 2026/1357, i datës 15 qershor 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2023/891 në lidhje me masat kufizuese, duke marrë parasysh veprimet që destabilizojnë Republikën e Moldavisë;

- 1.9. Vendim i Këshillit (CFSP) 2026/1351, i datës 15 qershor 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2024/2643 në lidhje me masat kufizuese, duke marrë parasysh veprimet destabilizuese të Rusisë;
- 1.10. Vendim i Këshillit (CFSP) 2026/1363, i datës 15 qershor 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2024/1484 në lidhje me masat kufizuese, duke marrë parasysh situatën në Rusi;
- 1.11. Vendim i Këshillit (CFSP) 2026/1364, i datës 15 qershor 2026, që ndryshon Vendimin 2014/145/CFSP në lidhje me masat kufizuese ndaj veprimeve që minojnë ose kërcënojnë tërësinë territoriale, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës;
- 1.12. Vendim i Këshillit (CFSP) 2026/1542, i datës 3 korrik 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2018/1544 në lidhje me masat kufizuese kundër përhapjes dhe përdorimit të armëve kimike;
- 1.13. Vendim i Këshillit (CFSP) 2026/1767, i datës 17 korrik 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2021/1277 në lidhje me masat kufizuese, duke marrë parasysh situatën në Liban;
- 1.14. Vendim i Këshillit (CFSP) 2026/1845, i datës 23 korrik 2026, që ndryshon Vendimin 2014/145/CFSP në lidhje me masat kufizuese ndaj veprimeve që minojnë ose kërcënojnë tërësinë territoriale, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës;
- 1.15. Vendim i Këshillit (CFSP) 2026/1723, i datës 13 korrik 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2020/1999 në lidhje me masat kufizuese kundër shkeljeve dhe abuzimeve të rënda të të drejtave të njeriut;
- 1.16. Vendim i Këshillit (CFSP) 2026/1705, i datës 13 korrik 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2023/2135 në lidhje me masat kufizuese, duke pasur parasysh aktivitetet që minojnë stabilitetin dhe tranzicionin e Sudanit;
- 1.17. Vendim i Këshillit (CFSP) 2026/1713, i datës 13 korrik 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2019/797 në lidhje me masat kufizuese kundër sulmeve kibernetike që kërcënojnë Bashkimin Evropian ose shtetet e tij anëtare;
- 1.18. Vendim i Këshillit (CFSP) 2026/1707, i datës 13 korrik 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2024/2643 në lidhje me masat kufizuese, duke pasur parasysh aktivitetet destabilizuese të Rusisë;
- 1.19. Vendim i Këshillit (CFSP) 2026/1709, i datës 13 korrik 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2024/1484 në lidhje me masat kufizuese, duke pasur parasysh situatën në Rusi;
- 1.20. Vendim i Këshillit (CFSP) 2026/1780, i datës 17 korrik 2026, që ndryshon Vendimin 2014/145/CFSP në lidhje me masat kufizuese lidhur me veprimet që minojnë ose kërcënojnë tërësinë territoriale, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës;
- 1.21. Vendim i Këshillit (CFSP) 2026/1836, i datës 24 korrik 2026, që ndryshon Vendimin 2010/413/CFSP në lidhje me masat kufizuese kundër Iranit;
- 1.22. Vendim i Këshillit (CFSP) 2026/1837, i datës 24 korrik 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2023/1532 në lidhje me masat kufizuese, duke pasur parasysh mbështetjen ushtarake të Iranit për luftën e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës dhe për grupet dhe subjektet e armatosura në Lindjen e Mesme dhe rajonin e Detit të Kuq, si dhe veprimet e Iranit që minojnë lirinë e lundrimit në Lindjen e Mesme;
- 1.23. Vendim i Këshillit (CFSP) 2026/1882, i datës 30 korrik 2026, që rishikon listën e personave, grupeve dhe subjekteve të mbuluara nga Vendimi (CFSP) 2026/455 për masat kufizuese për luftimin e terrorizmit;
- 1.24. Vendim i Këshillit (CFSP) 2026/1896, i datës 30 korrik 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2020/1999 në lidhje me masat kufizuese kundër shkeljeve dhe abuzimeve të rënda të të drejtave të njeriut;
- 1.25. Vendim Zbatues i Këshillit (CFSP) 2026/1850, i datës 24 korrik 2026, që zbaton Vendimin 2011/235/CFSP në lidhje me masat kufizuese të drejtuara kundër disa personave dhe subjekteve, duke pasur parasysh situatën në Iran;
- 1.26. Vendim i Këshillit (CFSP) 2026/1847, i datës 23 korrik 2026, që ndryshon Vendimin 2012/642/CFSP në lidhje me masat kufizuese, duke pasur parasysh situatën në Bjellorusi dhe përfshirjen e Bjellorusisë në agresionin rus kundër Ukrainës;

- 1.27. Vendim i Këshillit (CFSP) 2026/1849, i datës 23 korrik 2026, që ndryshon Vendimin 2014/512/CFSP në lidhje me masat kufizuese, duke pasur parasysh veprimet e Rusisë që destabilizojnë situatën në Ukrainë.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi konsiderohen të gjitha llojet e sanksioneve, emrat e individëve dhe entiteteve të sanksionuara, si dhe mallrat dhe produktet e përcaktuara, të listuara në aktet përkatëse të Këshillit të Bashkimit Evropian, sipas pikës 1. të këtij Vendimi, përfshirë anekset dhe çdo ndryshim, plotësim apo shfuqizim të tyre. Masat shtrënguese/kufizuese do të jenë në fuqi deri në një vendim tjetër dhe, varësisht nga rrethanat, mund të përditësohen, të plotësohen apo të ndryshohen.
3. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë